

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetar i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Mirë se erdhët në mbledhjen e rradhës së datës 27.11.2025 . Vazhdojmë me votimin për pjesëmarrjen

Enerieta Ferra – Zv. Kryetare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Bën apelin. Në sallë janë 38 Antarë të Këshillit Bashkiak.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kalojmë tek pika e parë për miratimin e rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak me 32 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetar i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 2 e rendit të ditës


2. Miratimi i proçesverbalit të muajit tetor datë 22.10.2025

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro,- kundër, 3- abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Kana A.Meçja: E.Murataj)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetar i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 3 e rendit të ditës

3. Për dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Znj. Erjona Ibrahim Jaurri

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kemi të bëjmë me një pikë të zëvendësimit të Anëtarit të Këshillit

Luiza Popja-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Të nderuar kolegë këshilltarë, komisioni I mandateve I përbërë nga Luiza Popja Kryetare, Rudina Mita Nënkryetare dhe Fatmir Vodollari Sekretar, morën në shqyrtim projekt vendimin për dhënien e mandatit Znj. Erjona Ibrahim Jaurri. Pas deklarimit të mbarimit para kohe të mandatit të Këshilltarit Z. Blendi Himçi I cili dha dorëheqjen, komisioni qendror i zgjedhjeve pas kryerjes së procedurave përkatëse ka marrë vendim për plotësimin e vakancës me kandidaten Znj. Erjona Ibrahim Jaurri, si kandidate e rradhës nga lista shumë emërore e subjektit zgjedhor Kualicioni Bashkë Fitojmë. Ky vendim I është përcjellë Këshillit Bashkiak me shkresën përkatëse Nr 6841 datë 30.10.2025 për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit. Për sa më sipër bazuar në ligjin për qeverisjen vendore komisioni I mandateve I propozon Këshillit Bashkiak votimin për dhënien e mandatit Znj. Erjona Ibrahim Jaurri. Faleminderit!

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Betimi: Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe do ti bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetësave të Bashkisë

Elbasan dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin e mirëqenien së tyre.

Erjona Jaurri-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Betohem

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit dhe punë të mbarë bashkarisht

Këshilli Bashkiak me 36 vota pro,- kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(E.Murataj)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetar i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 4 e rendit të ditës

4. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I Bashkisë për Muajin Tetor 2025

Rexhep Kaçuli-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Nga fondi I Bashkisë kemi 105 familje që përfitojnë, nga 87 që ishin për muajin Shtator dhe nga fondi I kushtëzuar kemi 266 familje nga 254 që kishte për muajin Shtator. Familjet e larguara janë ato që aplikojnë në sistem dhe ato që nuk plotësojnë kriteret. Them ta hedhim në votim.


Këshilli Bashkiak me 36 vota pro, 1 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Murataj)

(E. Muzhaqi)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Procesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetar i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 4.1 e rendit të ditës

4.1 Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar për Muajin Tetor 2025


Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, 1 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Murataj)

(E. Muzhaqi)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetar i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 5 e rendit të ditës

5. Për disa ndryshime në nivelin e taksave dhe tarifave vendore ne Bashkinë Elbasan, për vitin fiskal 2026.

Gledian Llatja – Kryetar i Bashkisë Elbasan

Faleminderit Z. Kryetar i Këshillit Bashkiak. Më lejoni si fillim tju uroj punë të mbarë. Paketa fikslae e cila është propozuar për tu miratuar sot në Këshillin Bashkiak është baza ose themeli i të ardhurave vendore. Ne ktu kemi tarifat e përgjithshme, të cilat në thelb janë shërbimet që ofron bashkia, ku zërat kryesorë janë tarifat e pastrimit, tarifa e gjelbërimit në qytet, tarifa e ndriçimit apo tarifa e mirmbajtjes së rrugëve rurale dhe patjetër të ardhurat sekondare të bashkisë ashtu siç janë për parkimet, të tjera që vijnë nga të ardhurat e infrastrukturës por edhe taksat e banesës të cilat janë tarifa të cilat miratohen me ligj. Kjo paketë fiskale është konsultuar në fakt me 18 Njësitë Administrative. Ktë vit ashtu si vitet e tjera kemi bërë konsultimet publike me qytetarët për buxhetimin me pjesëmarrje dhe paketën fiskale. Qëllimi i përgjithshëm për paketën fiskale është që të barazohen shpenzimet që ne kemi për shërbimet që ne ofrojmë me tarifat që mblidhen nga qytetarët. Shumë shërbime që ofron bashkia janë kostuar dhe ashtu siç do vit ka një rritje për disa nga tarifat edhe për shkak të rritjes së kostove. Paketa fiskale është konsultuar me qytetarët, me bizneset, me OJF-të, me grupe të ndryshme të interesit dhe patjetër që është parë edhe në mbledhjen e komisionit të Këshillit Bashkiak. Deri tani nuk kemi patur asnjë kundërshtim me shkrim nga paketa fiskale, as për ndonjë sistemim të mundshëm që mund ti bënim disa zërave por as edhe për kundërshtim. Kjo paketë fiskale do të vazhdojë dhe buxheti i Bashkisë së Elbasanit do të vazhdojë të mbështesi shtresat në nevojë. Në këtë paketë fiskale ne

vazhdojmë të mbështesim familjet me ndihmë ekonomike të cilat përjashtohen nga taifa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe tarifat për mirmbajtjen e infrastrukturës për njësitë administrative. Përjashtohen familjet që kanë banim në Bashkinë e Elbasanit, të cilat janë të regjistruara në regjistrat e Bashkisë së Elbasanit por që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, emigrantët. Atë që ne kemi thënë, dhe kemi bërë debate të ndryshme edhe në paketat e tjera fiskale me qytetarët kur ato nuk jetojnë në Shqipëri, pra janë emigrantë por e kanë gjendjen civile në Shqipëri. Në këtë herë I kemi përjashtuar të gjithë emigrantët të cilët janë familje dhe ndodhen jashtë vendit, nga tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit por jo nga tarifa e pasurisë, nga tarifa e pronës ata nuk përjashtohen. Kjo për arsye të mos ngarkimit të këtyre familjeve që kanë vite që janë shkëputur nga Elbasani dhe nuk kanë më kontakt të drejtpërdrejt me strukturat e qytetit dhe është një gjë e mirë që po bëhet. Ne kemi bërë edhe një risistemim të pritshmërive tona për tarifën e mbledhura ku apriori dhe detyrimisht sipas ligjit edhe emigrantët të cilët jetonin jashtë vendit duhet të tariforeshin, ndërkohë në këtë paketë fiskale ne I propozojmë Këshillit Bashkiak që emigrantët ose qytetarët e Elbasanit që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit familjarisht të përjashtohen nga tarifën vendore. Gjithashtu personat me aftësi të kufizuara, invalid, tetrapleëgjik, paraplegjik dhe të verbër, kur janë kryefamiljarë dhe nuk kanë persona të tjerë madhorë në familje me përjashtim të bashkëshortit/bashkëshortes përjashtohen nga tarifën e pastrimit, gjelbërimit ndriçimit dhe tarifa e mirmbajtjes së infrastrukturës për Njësitë Administrative. Tregtarët ambulantë në tregjet e miratuara nga Bashkia Elbasan përjashtohen nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit. Subjektet me objekt veprimtarie turizëm të tiptë punime artizanale, shitje suveniresh, bare dhe restorante të kulinarisë tradicionale dhe të ngjashme me to që ushtrojnë aktivitetin e tyre brenda mureve perimetrale të territorit të kalasë së Elbasanit dhe që janë deri në 40 m² përjashtohen nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit. Kuptohet kanë procedurat përkatëse të cilat duhet ti ndjekin, të gjitha rastet e përjashtimit në mënyrë që ti përfitojnë nga përjashtimi. Ne kemi një praktikë që duam të mbështesim bizneset të cilat ofrojnë turizëm dhe këto përfitojnë nga tarifën vendore të lehtësuara dhe të falura. Kjo është një mbështetje që e jep Bashkia e Elbasanit për bizneset e reja të cilat duan të hapen brenda mureve perimetrale të kalasë por kuptohet të jenë në standartin e zhvillimit turistik ashtu siç edhe ne duam të bëhet kalaja e Elbasanit ku po punohet më një projekt shumë të mirë për rivitalizimin e

kalasë. Kjo është një mbështetje fiskale për shtresat në nevojë, pensionistët e vetmuar, emigrantët siç u fol më lart për tu përjashtuar nga tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit. Gjithashtu janë përjashtuar edhe Organizatat Jofitimprurëse nga tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit të cilat nuk kanë kryer aktivitet ekonomik gjatë vitit para ardhës. Kto janë subjektet të cilat përjashtohen. Bashkia e Elbasanit vazhdon të ketë në fokus mbështetjen sociale për shtresat në nevojë, subjektet apo OJF-të. Për pjesën tjetër që janë në punë apo kanë një qarkullim ekonomik do të kërkojmë një rritje për disa nga tarifat që është ajo e pastrimit, tarifa ndriçimit që janë 2 nga tarifat kryesore. Tarifën e pastrimit ne kemi propozuar që të rritet në qytet me 400 lekë/vit ndërsa në fshat të rritet më pak me 13%. Tarifat në thelb janë baza ekonomike e bashkisë dhe patjetër që do të jenë një nga aktet kryesore për buxhetin dhe stabilitetin e Bashkisë së Elbasanit. Ne vazhdojmë të mbetemi një bashki me performancë shumë të mirë financiare ku jemi renditur në fakt edhe nga bashkitë e mëdha e para edhe përsa i përket fondit të performancës që kemi bërë. Do të vazhdojmë të kemi në fokusin tonë stabilitetin financiar pa ndikuar tek zhvillimi infrastrukturor dhe tek mbështetja për infrastrukturën. Gjithashtu disa nga tarifat që preken me ndërtimin dhe ato janë riparë. Është futur një model i ri në këtë paketë fiskale. Ashtu siç po futet gjerësisht në të gjitha bashkitë ku për shërbimet të cilat ofron bashkia patjetër që do të ketë edhe tarifën e vet të administratës. Koncepti jonë është që të kemi shërbime më cilësore, të kemi një shërbim më të mirë për qytetarët, nuk kemi dashur në asnjë rast të bëjmë rritje të tarifave në mënyrë disproporcionale por të kemi një tarifim të drejtë dhe të kemi një tarifim korrekt në bazë të tarifës. Do të vazhdojmë edhe në këtë vit fiskal të mbulojmë nga të ardhura të tjera përsëri një pjesë të ndriçimit dhe një pjesë të kostove që ne kemi për mbetjet dhe për trajtimin e mbetjeve. Vitin tjetër ashtu siç jeni informuar do të ketë edhe një rritje të rrogës minimale nga 40.000 lekë në 50.000 lekë, gjë e cila prek drejtpërdrejt pjesën e administratës së bashkisë dhe të shërbimeve të cilat ne nënkontraktojmë. Ajo që kemi bërë në vazhdimësi dhe që po bëjmë që po përgatisim buxhetin të cilin shumë shpejt do e kemi gati dhe do ta konsultojmë bashkarisht, është që shpenzimet të barazohen me të ardhurat apo të mbulojnë kostot e veta gjithsecila nga strukturat tona. Struktura e Ndërmarrjes së Punëve Publike për shërbimet e rrugëve rurale ne kemi patur aty një rritje të vogël të tarifës së mirmbajtjes së rrugëve rurale por përsëri është jashtë mase shumë e madhe pjesa për të cilat ne si Bashkia e Elbasanit fusim nga të ardhura të tjera për

mirmbajtjen e rrugëve rurale ndërkohë që e shohim të pamundur sado ta rrisim tarifën për mirmbajtjen e rrugëve rurale, tarifa të kapi koston e mirmbajtjes së rrugëve rurale. Ndërkohë edhe për kanalet kulluese dhe vaditëse, ka qënë një nga periudhat me intensitetin më të lartë të shiut dhe në territorin e Bashkisë së Elbasanit kemi patur pothuajse zero përmbytje. Kjo për shkak edhe të një pune që është bërë nga Ndërmarrja e Punëve Publike Rurale për pastrimin e kanaleve kulluese në mënyrë që mos kishim problematika. Ndërkohë patjetër që ka dhe një kosto të pastrimit të kanaleve kulluese vaditëse, një kosto që nuk plotësohet nga të ardhurat të cilat vijnë nga shërbimi që ofrohet. Për ne vazhdon të mbetet bujqësia dhe fshati në prioritet absolut dhe do vazhdojmë të mbështesim përsëri pjesën e bujqësisë sidomos kanalet kulluese dhe vaditëse me të ardhurat e tjera për shërbimet që ofrohen. Sado ti rrisim përsëri tarifat e vaditjes e të kullimit, ato nuk do ta plotësojnë dot koston të cilën ne kemi për pastrimin e tyre. Është bërë një punë e madhe për pastrimin e kanaleve kulluese e vaditëse dhe tarifat janë shumë larg koston që ne kemi. Megjithatë duke patur një kosto dhe një shërbim më të mirë patjetër që kemi kërkuar të rriten disa nga tarifat në mënyrë proporcionale, disa nga tarifat që ne ofrojmë për shërbimin e kullimit dhe të vaditjes. Kemi diskutuar me disa nga këshilltarët, ishte dhe një propozim për uljen e një tarifeje, jemi plotësisht të hapur për ta diskutuar dhe për ta mbështetur çfarëdo lloj sugjerimi që do ketë përsa i përket pjesës së tarifimit në zonat rurale. Po punojmë për të futurë një sistem të ri të tarifimit të ndriçimit, kemi rritur sipërfaqen e ndriçueshme nga 23-33 km gjatësi, e cila kthehet në një kosto për faturat që ne paguajmë për energjinë elektrike, gjë e cila kërkohet të pasqyrohet edhe tek tarifa përkatëse. Po mendojmë një model tjetër të cilën po mendojmë ta fusim në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2026 në mënyrë që në zonat rurale aty ku ofrohet shërbimi i ndriçimit të mbledhet vet nga fshati ajo që konsumohet. Sot asnjë nga fshatrat tonë nuk arrin dot të mbulojë koston e faturës së energjisë elektrike për ndriçimin e tyre. Është gjë tjetër qyteti ku ndriçimi përdoret nga shumë veta, përdoret edhe nga ato të cilat vijnë nga zonat rurale dhe kanë shërbimet në qytet, ashtu edhe nga vetë qytetarët ndërsa në zonat rurale aty ku nuk ka dhe nuk konsiderohen si zona turistike siç janë Gjinari apo Funari ku mbulohen edhe nga të ardhura të tjera nga turizmi, do të përpiqemi që të konsultohemi bashkarisht bashkë me kryepërgjigjuesin dhe me komunitetin një model të tarifimit përkatës për faturën e energjisë nga vetë fshati, në këtë mënyrë duhet të jemi shumë herë më të hapur edhe për të shtuar investimet

në fshat por edhe për të paguar çdo fshat faturën e vet të energjisë elektrike. Kjo është një pjesë e paketës fiskale, vazhdojmë ashtu siç e thashë edhe në fillim, të mbetemi një bashki sociale ku qëllimi jonë kryesor është që të mbulojmë kostot që ne kemi për shpenzimet administrative ti mbulohen nga tarifat ashtu siç e kërkon edhe ligji. Për tarifa të caktuara ashtu siç është tarifa e pastrimit ku flitet për pastrimin e qytetit, të fshatit dhe të trajtimit të mbetjeve, përsëri do të kemi një mbështetje nga qeveria dhe nga të ardhura të tjera të buxhetit të bashkisë. Edhe tarifa e ndriçimit pavarësisht se kemi propozuar një rritje, përsëri do të ketë një mbulim të kostove nga të ardhurat sekondare nga të ardhura të tjera të bashkisë. Gjithashtu po përgatitemi dhe për buxhetin të kemi një sërë paketash investimi për të vendosur panele voltaike dhe energji të rinovueshme për sistemet tona të konsumimit të energjisë ashtu siç janë Institucionet apo edhe zona të caktuara rurale. Faleminderit!

Shefqet Bullari-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Realisht është bërë një analizë e hollësishme deri tani që kanë pësuar ndryshime në tarifat e Bashkisë Elbasan. Është një grup pune që ka ngritur bashkia për të parë disa tarifa të paketës fiskale të vitit 2026 dhe grupi I punës ka sugjeruar rritjet që shkojnë nga 11.3-20%. Realisht edhe taksa e pastrimit që mos ndoshta ndikon në shifra absolute, kush mund ta përdorë edhe politikisht por po të shikojnë tabelat krahasuese të 10 bashkive kryesore, Bashkia Elbasan ka tarifën më të ulët të pastrimit kur të tjerët e kanë nga 35.000 -50.000 tek ne shkon 20.000 lekë. Drejtoria përkatëse ka bërë një analizë të hollësishme të kostos. Ka bërë tabelat krahasuese të shtimit të shërbimeve të pastrimit për vitin 2024-2025, I krahason aty me 2025-2026 dhe po të shikojmë tabelën krahasuese ka një shtim të elementëve të shtimit të shërbimit të pastrimit që tregon që do të ketë një cilësi pastrimi më të mirë për qytetarët prandaj është e justifikueshme edhe rritja e tarifës. Tarifat e tjera ju pak a shumë I keni në dispozicion, kanë rritje jo më shumë se 20%, qëllimi ka qenë që të shikojnë drejt kostove reale. Tarifat duhet të mbulojnë kostot reale të shërbimeve përkatëse dhe kjo tarifa do të përkthehen në të ardhura që do të përmirsojnë shërbimet përkatëse në kjo tarifa. Nuk dua të zgjatem sepse kryetari përmendi të gjitha tarifat dhe ne jemi dakort që të votohet.

Bianka Çopja-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Përsëritet. Sot po diskutojmë një paketë fiskale që tregon shumë qartë jo nevojat financiare të bashkisë por nivelin e keq qeverisjes së saj. Të fillosh me një rritje 20% të taksave, është vulosje e paaftësisë së kësaj bashkie. Në vend që të ulni shpenzimet, ju I rrisni taksat qytetarëve të Elbasanit. Në vend që të manaxhoni më mirë, mbuloni gabimet me kto rritje taksash. Po flisni për një rritje taksash për pastrim, për çfarë pastrimi? Sepse qytetarët përditë shikojnë kosha të mbushura plot. Çdo ditë hasen me plehra kudo në rrugë. Me lagje të cilat janë në mëshirë të fatit dhe mbi të gjitha me çfarë fytyre I paraqiteni qytetarëve me këtë rritje taksash? A e keni rritur ju shërbimin me këtë rritje taksash? A është rritur shërbimi I ndriçimit? A është rritur shërbimi I pastrimit? Kur pastrimi sot tek ne nuk ka as mjetet e duhura. Ka kontrata të cilat vazhdojnë dhe nuk mbikqyren nga askush. Ju dakort mund ta keni numër për ta kaluar këtë paketë fiskale siç bëni në shumë raste, por nuk mund ta shisni këtë paketë fiskale si diçka normale për qytetarët. 20% nuk është aspak një vlerë e vogël për rritjen e taksave të qytetarëve. Do bëni mirë që kur bëni të tilla rritje taksash të bëni një analizë të detajuar mbi të gjitha dhe ti shfaqni këto analiza. Kur ju çohen kërkesa të keni minimumin e qytetarisë dhe respektin për ti kthyer përgjigje. Patjetër që do jem gjithmonë kundër rritjes së këtyre taksave të qytetarëve përsa kohë nuk ka një rritje të shërbimit në këtë qytet. Faleminderit!

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Duhet të pranoj që në komisionin e ekonomisë pati një debat shumë të hollësishëm përsa I përket nivelit të tarifave dhe gjithashtu në sensin profesional duhet të pranoj diçka që është. Një institucion siç është bashkia apo edhe më lart që është qeveria, nuk mund të funksionojë buxheti nëse nuk ka mbledhje të ardhurash. E vetmja mënyrë e të ardhurave janë taksat edhe tarifat. Kur flasim për tarifë flasim për mbulim kostosh dhe sigurisht kur flasim për mbulim kostosh pretendojmë që të ketë një analizë që unë ju falenderoj që e keni bërë në përmbledhjen e këtij viti, ashtu siç unë jua kam kërkuar 2 vitet e kaluara sepse I keni pasqyruar dhe kostot. Debati jonë atë ditë në komision u fokusua diku tjetër. Ju klasifikoni familjet, bizneset kryesisht pastaj në të vogla me tvsh, të vogla me tvsh, apo dhe biznese të mëdha. Brenda këtyre kategorive ju përfshini biznese të cilat përkufizohen si të tillë vetëm për shkak të fitimit ekonomik që ka në fund të vitit e cila deklarohet pranë drejtorisë së tatimeve. Duke qenë se bashkia I ka të gjitha instrumentat në

dispozicion sepse ka dhe të gjitha institucionet përkatëse të cilat mund të monitorojnë edhe bizneset .Diskutimi im u përqendrua në faktin që nëse flasim për biznes të vogël bar kafe, minimarket, tabakino, fruta perime, jo të gjithë këto për shkak të nivelit të të ardhurave që kanë do të thotë që ndotin në të njëjtën mënyrë.Pra një tarifë duhet të jetë proporcionale krahasimisht me ndotjen që shkakton.Një tabakino nuk prodhon një lloj mbetje ashtu siç prodhon një hotel, nje restorant apo një agro turizëm.Edhe pse e dëgjova fjalën e kryetarit që tha kjo bëhet në mënyrë të tillë që ti lehtësohet aktiviteti por nëse bashkia do të monitoronte mirë këto biznese duhet të proporciononte tarifën dhe jo ta vinte në mënyrë të mesatarizuar.E njëjta gjë ndodh edhe në lidhje me familjet, jo çdo familje ndot njëlloj.Ka familje me 2 pjestarë, ka familje dhe me 10 pjestarë.Koshat nuk I mbushin njëlloj të dyja kto tipologji familjesh.Meqënëse juve keni njësi administrative, staf mjaftueshëm, pse nuk kategorizoni dhe ti vini një faturë individuale çdo familjeje?Pse çdo familje duhet të paguajë një faturë të mesatarizuar?Ndërkohë që jo çdo familje bëhet pjesë e mesatarizuar e kostos.Një moment I dytë shumë I rëndësishëm që u diskutua atë ditë ishte:ok janë rritur kostot por ky raport duhej të shoqërohej edhe me një raport të mbledhjes të taksave dhe tarifave.Ku jemi sot?Sa përqind e taksave dhe tarifave është mbledhur aktualisht në këtë fundvit nga Bashkia Elbasan?Sepse ne duhet të jemi transparent, kto rritje po mbulojnë humbjet nga vitet para ardhëse apo po mbulojnë vetëm koston për vitin aktual?Ato humbjet që janë nga vitet para ardhëse kush I mbulon?Kështu që kryetar kur flasim për performancë duhet të kemi parasysh edhe atë që ishte, jo vetëm atë që po flasim sot.Ndaj kto janë 2 kërkesat e mia edhe uroj shumë me gjithë punonjësit që keni shtuar në organikë, ti vini në zbatim.Faleminderit!

Gledian Llatja – Kryetar i Bashkisë Elbasan

Ne kemi sot një qytet shumë herë më të pastër, ka një monitorim të vazhdueshëm të kontratës së pastrimit edhe në fshat edhe në qytet.Kemi futur pastrimin edhe në zonat rurale në të gjitha fshatrat, në të gjitha njësitë administrative.Kemi një pastrim më të mirë të qytetit, kemi patur një periudhë kohe problematika për rrugët të cilat kanë qenë të hapura nga ujësjellësi ku shërbimi I pastrimit është ofruar pjesërisht.Është e vërtetë kjo që ka pasur gjatë periudhës së verës një problematikë

të tillë. Ka patur një shërbim shumë herë më të mirë, do të ketë vitin tjetër një shërbim akoma dhe më të mirë. Do të kemi një model tjetër të pastrimit të disa akseve të cila vitin tjetër I marrim me kontratën e re në dorëzim, ashtu siç është aksi nga rreth rrotullimi I Bradasheshit deri në dalje të qytetit të Elbasanit, dhe rruga e vjetër e Metalurgjisë, rruga që të çon tek fabrika e çimentos, të cilat në thelb vazhdojnë të mbeten rrugë nacionale por që I ka marrë Bashkia e Elbasanit për menaxhimin në pronësi kështu që kemi parashikuar edhe aty një pastrim të këtyre rrugëve me fshesë pasi nuk është e mundur të pastrohet me puntorë. Gjithashtu është parashikuar në të gjithë rrugët e reja që janë shtruar gjatë këtyre viteve që janë shumë, në qytet të pastrohen të kenë një cikël të vetin të pastrimit dhe do të ketë një kosto të tyre. Bashkia Elbasanit është administrata qendrore, është aparati I bashkisë, në thelb vazhdon bën politikat dhe shumë shërbime të tjera të cilat ne mund ti ofronim me kompani private apo me shërbime të caktuara, ne vazhdojmë ti bëjmë vetë ashtu siç vazhdojmë të bëjmë edhe pastrimin e zonave rurale në fshat. Kjo sjell një rritje të koston së drejtpërdrejtë të puntorisë pasi rritet dhe paga minimale dhe ajo mesatare. Do të ketë edhe një rritje të shpenzimeve të cilat automatikisht do pasqyrohen në një shërbim. Kur flasim për rritje ashtu siç jua thashë edhe më parë flitet për 408 lekë në vit ose 32 lekë në muaj për një familje për pastrimin në qytet. Në zonat rurale patjetër që është më pak. Ndërkohë që do të vazhdojmë të bëjmë shërbimin e pastrimit edhe në Njësitë Administrative Tregan por edhe në Gjinar ku është bërë një investim I ri për tu pastruar në vazhdimësi. Përsa I përket mbledhjes së tarifave ne kemi qen shumë transparent ku çdo vit kemi ardhur në Këshillin Bashkiak mos gaboj në muajin mars dhe kemi bër një detajim të mbledhjes së tarifave. Megjithatë nëse do të duhet përsëri kur është data në muajin mars do ta bëjmë përsëri atë por nuk është mbyllur viti fiskal që ne të dalim me një të dhënë të saktë të mbledhjes së tarifave. Është e vërtetë që ka një mënyrë përlllogaritje të tarifave të pastrimit dhe të ndriçimit për familje. Është marrë për bazë një familje me 4 veta pra është marrë mesatarja. Nuk e tarifojmë dot që të bësh një model të tarifimit për familje më 1,2 apo 5 persona. Është formula përkatëse e cila merret me familjet. Familjet të cilat nuk janë të lidhura me pronën dhe me kontratën e ujësjellësit automatikisht kto tarifohen nga Njësia Administrative në bazë të tarifave që janë përcaktuar. Patjetër që mund të jetë një model edhe ai, mund të ketë kohë për diskutime. Kur është bërë paketa fiskale dhe është bërë kjo ndarje, jo sot por me kohë, është marrë një ekspertizë e jashtme për të bërë siç bëhen modelet më të mira dhe mesatarja më e

artë. Megjithatë është një gjë që mund të vlerësohet dhe mund të kërkojmë ekspertizë përsëri për vitin tjetër për të marrë tarifimet. Do ju kërkoja ndjesë pasi më duhet të lëviz nga ora 2 dhe do të le nënkryetarin këtu. Faleminderit!

Erion Murataj – Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Duke I hedhur një sy paketës fiskale, duke dëgjuar edhe parafolësit, mu duk vetja si në realitet paralel. U fol këtu për përmirsim të infrastrukturës, për pastrim më të mirë, për shtesë ndriçimi, në fakt Elbasani po përjeton një nga momentet më të vërteta historike përsa I përket infrastrukturës e në fakt përsa I përket pastrim gjelbërimit duhet të jemi falenderues zonës rurale e cila e gjelbëron hartën e Elbasanit sepse përsa I përket zonës urbane gjelbërimin jo vetëm që nuk e kemi po dhe atje ku është turremi ta betonizojmë. U fol këtu për ta detyruar fshatin për të paguar vetë ndriçimin. Kaq e kaq vite që I keni marrë taksa fshatit ku janë? Ça janë bërë? U fol këtu që do përjashtohen fshatrat turistike si Gjinari ndërkohë që ai turisti që do shkojë në Gjinar duhet të kalojë në Hajdaran, duhet të kalojë në Mlizë, do duhet të kalojë në Lleshan, në Shelcan. U fol këtu pastaj për analizë po asnjë nuk analizoi se sat ë vështirë jua keni bërë jetën qytetarëve të Elbasanit. E kur them ja keni bërë, ja ka bërë e gjithë kasa drejtuese e Elbasanit në 35 vite. E nuk ka dyshim që sot është momenti më I keq historik I këtij qyteti. Edhe I atyre që kur kanë ardhur në atë karrige kanë ardhur duke sharë punën e atyre që ishin përpara, të cilët sot shkëlqejnë nga atje ku janë në raport me ata që mburren për punë të paqëna. E në fakt nëse do hymë te shifrat ku kolegu që raportoi pjesën e komisionit të financave tha që qytetet e tjera e kanë më të lartë. Është e vërtetë qytetet e tjera kanë tarifa më të larta por qytetet e tjera janë qytete, nuk janë katandisur në fshatra me beton si Elbasani, nuk janë katandisur si hyrje qyteti si kryqëzimi I Cerrikut dhe për ta mbyllur duke parë këtë paketë fiskale merr kuptim ligji 9970 për barazinë gjinore të cilën klasa politike shqiptare e ka miratuar. Faleminderit!

Altin Mecja – Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Kryetar unë dua që herë tjetër kur ngremë dorën nuk duhet të jemi subjektiv se kë kemi qejf, mbaj një farë rradhe se dhe unë di të ulëras. Unë dua ti drejtohem Kryetarit të Bashkisë..

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Rradha është pasi raporton një përfaqësues I bashkisë është kryetari I komisionit përkatës pastaj kryetarët e grupeve, dhe po të ishte për mua duhet ti kisha dhënë fjalët grupit të PS pastaj ta merrje ti ...

Altin Meçja – Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

E kam me Kryetarin e Bashkisë, kryetarin që kanë zgjedhur pa votën time.Unë di që procesi I buxhetimit me pjesëmarrje nuk duhet të ulen deputetët e partisë socialiste apo kreu I listës së PS-së.Aty krah teje duhet të jenë juve, nënkryetarët dhe punonjësit.Deputetët mund të marrin pjesë po thjesht të jenë si dëgjues.Ata të morën ty gjithë hapsirën politike apo hapsirën e komunikimit.Në një mbledhje tjetër pashë edhe kryetaren e PS Znj.Urupi.Është shkelje e autonomisë vendore, jo të ulet në panel drejtues.Deputetët mund të marrin pjesë sepse buxheti me pjesëmarrje duhet të mbetet zëri I komunitetit dhe jo zgjatim I qeverisë vendore sepse ti po e sheh gjithë lojën e Tiranës që po I vijnë llamarinave majtas djathtas sepse ka dalë shejtani nga shishja atje, do ta ngecin ty se ti je I zgjedhuri dhe ti firmos bashkë me këto zotërinjtë e tjerë.Mazniku ja fut vrapit bashkë me deputetët e tjerë se skanë firmosur.Unë jam për po...jam aq I shkolluar sa pët të dhënë mend ty edhe kryetarit tim dhe atij tëndit po deshe.I keni rrit taksat në fshat, tarifat...po të jetë për të kap ty unë me shprehjet je fiks chatgpt-ja, ...e lem partinë se partia është aty, duhet të kemi një vet respekt për veten dhe një pavarësi me veten.Jan rritur tarifat..të ikën fare edhe ato 5 banorë që janë në fshat?I keni rrit dhe tarifat e ndriçimit, në fshat janë një dritë ktu e një dritë atje...e paguajmë ne po të paktën të vihen...po deshe hajde shkojmë bashkë I shohim.Sa për këto që unë thash, kto janë shumë të vërteta të gjitha dhe ti I di shumë më mirë sesa unë këto..që deputetët e PS-së nuk ulen në panel drejtues.

Valbona Balliu – Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

I nderuar Zoti Kryetar, të nderuar kolegë.Pikë së pari duhet të pranojmë diçka që është tepër e dukshme vet dhe zotërinjtë jeni përfaqësues këtu domethënë në siglën e partisë socialiste ndërsa pjesa këtu është pjesa opozitare dhe paradoksi është që ne flasim për ulje taksash ndërkohë që ju frymën kryesore e keni çështja sociale dhe politika sociale.Ju ngrini taksa dhe na keni dalë më të djathtë, më kapitalistë sesa ne të cilat kemi këtë linjën konservatore.Ktë gjë duhet ta pranojmë.politika

sociale duhet të jetë prioriteti juaj dhe ulja dhe ngritja e taksave ka të bëjë me 2 parimet kryesore o je konservator se ne nuk jemi komunist, ne e dimë që shteti funksionon me rritjen e taksës, jemi forcë e cila është ndërtuar mbi familjet e pasura, mbi bizneset. Ju jeni për shtresën e mesme dhe të varfër të paktën kshu funksionon në çdo vend të botës. Ne ngrejmë zërin për ulje taksash dhe ju njëkohësisht rritjen e tarifave dhe të taksave e keni politikë të vazhdueshme. Unë jam për ngritje taksash, një shtet nuk funksionon pa taksa por ktu duhet të bëhen disa diferencime. Dorisi ngriti një problematikë, tarifa fikse është më e lehtë për përllogaritje. Problematika tjetër është që mban një armatë të tërë administratë publike dhe kjo është mënyra më e lehtë për ta vjelë taksën, nuk lodhet shumë ekonomisti, vihet një tarifë fikse etj. Ne kemi plot njerëz që jetojnë vetëm 1 person që nuk ka ndërtuar familje dhe të paguajë njësoj me një familje me 5 antarë. Ose një çift nuk po themi pensionistë sepse pensionistët janë të përfshirë në këtë fashë edhe më pëlqen që ata mos paguajnë tarifa pastrimi dhe shtresat e marxhinalizuara por ka familje në nevojë mbi të cilat bie barra fiskale kryesisht. Gjëja tjetër është, biznesi I madh firmë ndërtimi dhe biznesi vip në çdo vendodhje. Midis këtyre bizneseve, një firmë ndërtimi ne e dimë çfarë mund të jetë një gurore etj etj ndërsa biznesi I madh mund të jetë edhe industri e rëndë, mund të jetë Kurumi etj etj dhe çuditërisht diferenca e taksës midis këtyre të dyjave është 0.5 a 0.7 %. Ka mundësi që të jemi pak më të drejtë? Ai që fiton më shumë duhet të paguajë më shumë, unë kështu e konceptoj. Sepse ju ndryshe nga taksa e sheshtë e Sali Berishës, Edi Rama kur erdhi në pushtet në vitin 2013 vuri qellimin e tij fiskal tek taksa progresive. Besoj të gjithë e dini ju këtë. Kto aplikimet e tarifave fikse mua më ngjajnë me taksat e sheshta, prat ë jemi pak më të drejtë në këtë pikëpamje. Do të thuash është e vështirë të ndodh kjo. Zotëri ke një armatë të tërë administratë publike, ti diagnostifikojnë sa e kanë firmën e fitimit, të dhënat I merni nga tatimet etj etj qoftë edhe tek bizneset, po paguan hoteli njësoj me tabakinon. Çfarë ndoti tabakino 2 me 2? Unë gjykoj që duhet ta keni parasysh këtë fakt.

Hektor Çiftja – Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Përshëndetje të gjithëve, diskutimi I sotëm ishte një diskutim që unë personalisht e kam prit me ankth të madh. Çdo vit rritja e taksave është goditëse, është si ulja e çmimeve për gratë nëpër supermarketet. Një gjë nuk kuptoj tek opozita, kemi një opozitë të mrekullueshme që thotë bashkia ka punuar keq sepse ka taksa të ulta, duhet të punojë më mirë ti rrisi taksat dhe ky është një lajm I jashtëzakonshëm. Unë

nuk e di ku janë mediat këtu dhe ta japin këtë gjë. Ta rrisin edhe këtë edhe këtë...do ishte fantastike. Nuk jam ekonomist, di vetëm një gjë të arsyetoj. Di të arsyetoj që së pari, nëse opozita di të kritikojë dhe të bëjë retorikë për procesin e taksave le ta bëjë për procesin e pjesëmarrjes publike. Nëse nuk kanë marrë pjesë në takimet publike për diskutimin e taksave nuk kanë të drejtë të flasin. Së dyti bëhet fjalë për performancë ekonomike të institucionit të bashkisë, kjo është tjetër gjë, të lutem të mbaroj. Ajo që nuk kuptoj unë është që po flasin njerëz që kanë një ndarje. Ne duam një bashki me performancë ekonomike, shërbimet janë tjetër gjë, shërbimet janë të kritikueshme, I duam më të mira. Po performancën ekonomike të bashkisë a e duam, po institucionin e duam më të fortë? Po që kjo ndarje administrative kërkon burime financiare nga do ti gjejë kjo bashki? Për të rregulluar këto atëhere kjo mjafton të diskutojmë ose të votojmë nëse kjo paketë fiskale e rrit performancën ekonomike të bashkisë, treguesit ekonomikë të bashkisë a I rrit? A e forcon këtë bashki? Dhe pastaj ne diskutojmë shërbimet, është një diskutim tjetër. Për këtë arsye për këtë ndarje unë propozoj që të hidhet në votim.

Zamir Muzhaqi-Zv.Kryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Dua të bëj një analizë të thjeshtë, ndoshta më të prekshme për qytetarët sesa për ne të cilët e kemi kaluar si material por meqë kryetari I grupit të partisë socialiste më ngacmoi duhet ti bëj një replikë pak sekondashe. E para nuk dëgjova nga asnjëri nga antarët e opozitës që morën fjalën që të mos jenë dakort me performancën dhe të jenë dakort me ngritjen e tarifave dhe taksave. Pra që mos bëjmë lojë fjalësh, unë nuk e dëgjova këtë. Dhe këtë duhet ta them Hektor si mik, prandaj po ta bëj edhe replikën. Gjithashtu jemi dakort shumë për rritjen e performancës sepse për këtë jemi votuar. Kryetari I Bashkisë kur foli tha që jemi nga bashkitë e para madje tha jemi bashkia e parë, me rritjen e performancës tha nga bashkitë e mëdhaja të Republikës. Pra ne I kemi rrit nivelet e performancës sipas Kryetarit të Bashkisë, për performancë ekonomike foli kryetari nuk foli për fizike sepse ishte po te e njëjta temë. Hektor të lutem, ishte replika e dytë që doja të ishte ...

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Respektoni shokun ju lutem..

Zamir Muzhaqi-Zv.Kryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Dhe e treta replikë që do bëja me kryetarin e grupit parlamentar të partisë socialiste është ajo që përsëri e përmenda....spo më lenë me fol..një fjali kam thënë deri tani...dhe do ta bëj unë replikën sepse për këtë punë kemi ardhur.Nëse e keni me ngut hajde ikni, le të rrinë ato që se kanë me ngut.Po flasim për jetën e qytetarëve për ngritjen e tarifave dhe taksave ..tani hajde të flasim nga një minutë a dy minuta.U kujtove mbas dy vjetësh tit më tregosh mua dy minuta.E kam edhe për replikë sepse nuk mund ta le pa replikë, kam përfaqësues politikë këtu.Hektor në dijeninë time anëtarët e Këshillit Bashkiak si majtas si djathtas janë bërë pjesë e Buxhetimit me Pjesëmarrje.E dyta në Buxhetimin me Pjesëmarrje nëse është fol për rritje tarifash dhe taksash atëhere flasim ndryshe.Në asnjë sekondë nuk është fol për rritje tarifash dhe taksash.Kështu që mos na I hiq atë të drejtë që ai që ska qenë le të iki, ai që ka qenë le të rrijë.Dua të bëj një analizë,më fal për replikën por meqë më ngacmove doja ta bëja këtë.Unë edhe në komision e mora fjalën dhe bëra një pyetje të cilën e kam akoma peng dhe thashë që në raste të tilla duhet bërë një analizë e thellë mbi ndryshimet që kërkon bashkia për tarifatat dhe taksat vendore.Dhe duke patur parasysh të kjo analizë e thellë, kisha parasysh të dyja anët e medaljes.Ana sesi performon, sesi duhet të performojë me këtë rritje bashkia pra rritja e buxhetit të bashkisë dhe nga ana tjetër sesi mund neve si paketë fiskale mund të bëhemi një barrë për qytetarët e Elbasanit dhe për biznesin.I ka të dyja këto anë medalja.Dhe për të bërë një analizë sot kur erdha këtu sa më të këndshme, u konsultova me disa nga grupet që janë të ngjashëm si ne nga Kosova.Prizreni është një qytet pak a shumë si I joni që ka pothuajse po të njëjtën popullsi dhe pothuajse po të njëjtat zhvillime me ato zhvillime që duam të bëjmë ne, me turizmin me kalanë.Atyre u ishte dashur që të nxjerrin një draft kontratë për rregulloren mbi tatimet dhe tarifatat, mbi 3 vjet konsultime publike.3 vjet jo 1 muaj konsultim për buxhetin dhe për partinë.Paketa e re fiskale nga fillimi në fund është një barrë e re e shtuar për qytetarët e bashkisë si dhe për bizneset.U vu theksi shumë tek pastrimi.Në material janë 7 pika, 7 grupe tarifash të cilat të gjitha janë të ngritura dhe jo vetëm me 20% por kemi dhe tarifa të cilat kanë kaluar 100%.Nëse doni jua bëj me dije por besoj se materialet I keni përpara, ka tarifa këtu të cilat e kalojnë edhe 100%-shin nga ajo që ka qenë.Do doja shumë që performanca e Bashkisë Elbasan të ishte në nivelet e duhura, do doja shumë që qytetarët e Elbasanit ta ndjenin performancën e mirë të bashkisë por besoj që nëse anketohen

qytetarët e Elbasanit do ti kemi të gjithë kundra për një performancë më të mirë dhe jo të kënaqshme për bashkinë. Kam frikë se përveç se një paketë e cila do jetë një barrë për qytetarët dhe për bizneset, është edhe një paketë për ata të cilët e paguajnë. Pak e preku Dorisi për çështjen se jemi në fund të vitit dhe duam të dimë sesa jemi në mbledhjen e tarifave dhe taksave të bashkisë. Mesa di unë në 1 apo 2 mbledhje më përpara ne nuk kemi arritur 60%-shin të mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore të bashkisë. Është një pjesë e cila paguan dhe I rritet taksa dhe tarifa. Për pjesën e fundit është bërë mirë që disa nga fashat e caktuara sociale janë përjashtuar nga tarifat dhe është për tu komplimentuar edhe ky I zonjave që kanë bërë disa amendamente për tarifat dhe stafi I bashkisë I është përgjigjur pozitivisht. Si përfundim do thoja që duke qenë se nuk jam optimist dhe e shoh rritjen e paketave fiskale si një barrë të shtuar për të gjithë ne dhe për bizneset sidomos ku numri I tyre dita ditës zvogëlohet. Do jem kundra këtyre ngritjeve dhe do votoj kundër. Faleminderit!

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kam gati gjysëm ore që e kërkoj fjalën edhe të paktën unë kam qenë një prej atyre që isha në komision dhe kam ngritur disa prej atyre të cilat tha zonja Doris, shqetësime dhe sugjerime. Kështu që më takon edhe të flas dhe të bëj edhe atë përmbledhjen e fundit nëse sdo ketë njeri më. Këtu ose se keni lexuar, këtu nuk flitet për paketë fiskale, flitet vetëm për ndryshim tarifash. Paketa fiskale na vjen një muaj më vonë dhe ajo do debatohet se ku do shkojnë paratë. Këtu po flitet në nivelin thjesht të mbledhjes së parave që ju duhen për paketën fiskale. Shumë gjëra tek biznesi kanë llogjikë dhe më pëlqejnë disa pika aty, disa biznese aty që janë përcaktuar që janë ndotës të mëdhenj, le të tarifohen më tepër sepse realisht ato ndotin më tepër, por ju nuk keni të drejtë ti rrisni qytetarëve të Elbasanit 24% se u tha për 20%. Është 24% rritja për 23.636 familje qytetare të qytetit të Elbasanit, ndërsa për fshatrat është 12.3% dhe në taksa që ju thatë do të mbledhni 4.000 lekë se Kryetari e tha kështu se për familjen e tij nuk është asgjë 4.000 lekë për pastrimin dhe 3.000 lekë për ndriçimin por janë 7.000 lekë. Po të marr vetëm këto 2 tarifa pa futur të tjerat që do vijnë në mënyrë indirekte që do vijnë nga biznesi sepse këtë koncept unë e kam sepse jam biznesmen. Kështu që çdo rritje taksash në mënyrë indirekte sjell edhe tek qytetarët rritje të kostos dhe një prej asaj që do të vijë do të jetë që do të vini tarifim për kalimin e linjave të internetit dhe të shërbimeve të celularit. Dhe kjo në mënyrë indirekte do të sjelli rritjen e paketave të

çdo qytetari të Elbasanit. Që ta dinë çfarë rritjesh do kenë dhe për vetëm 23.634 familje ju do të mbledhni 165.438.000 lekë të vjetra, vetëm me këtë rritje taksash. Pa shtuar sesa është komplet rritja e taksës, vetëm me këtë 7.000 lekësh që do ti merrni më tepër shiko sa do ti fusni duart tek familjet qytetare dhe unë këtu e kam shqetësimin sepse këto janë edhe njerëzit që juve para 2 vjetësh I keni kërkuar votëbesimin dhe në konsultim publik për shumë ose për vete sepse unë kam marrë pjesë te lagjia ime, nuk u fol fare për rritje tarifash. U fol që bashkia do të bënte aq punë të mira sa që mua mu duk vetja si puna e asaj barsaletës, dua të jetoj në Elbasan, nga ato gjëra të bukura që dëgjova aty. Për fat të keq aty nuk kishte asnjë qytetar, ishin të gjithë administratë edhe patronazhistë se unë I njifja të gjithë. Dhe që ta sintetizojmë sepse u fol këtu e djathta. E djathta është gjithmonë për taksa të ulta dhe këtë e ka demonstruar partia demokratike se po mar në mbrojtje atë që unë nuk kam qenë pjesë e partisë demokratike në atë kohë. Taksa e sheshtë demostroi shtim të numrit bizneseve, shtim të popullsisë, rikthim të emigrantëve. Taksa progresive dhe këto 2 taksa që rriten çdo 2 vjet, po ju rikujtoj se në 2023 I rritët prapë me 20% dhe po I rrisni përsëri. Ndryshimi I shpeshtë I taksave sjell shpopullim, sjell varfëri dhe për të thenë dhe atë që tha kryetari se ne apo shumë prej opozitës po bën punë me superlative për bashkinë. Mjafton dilni nga dera e bashkisë, djathtas kujdes mos rrëshkisni se unë desh rrëshkita. Kto janë punët e mira të bashkisë. Dhe po ju rikujtoj rrugët. Në 20-30 vjet në Elbasan unë nuk di të jetë bërë që rrugë. Më falni se është vetëm njëra, është ajo që të çon në botën tjetër. Vetëm atë e keni bërë rrugë të re. Ajo është rruga më e re që ka bërë bashkia, kjo është performanca. Kështu që unë votoj kundër për të gjitha këto arsye dhe I them qytetarëve Elbasanas që të shtrëngojnë rripin se partia ka nevojë për pagat që do të rrisi. Më falni dhe një pikë kisha se kjo rritje po vjen për të mbuluar pagën që juve do të rrisni, pagën minimale dhe ta trumbetoni në zgjedhjet e ardhshme. Me taksat e qytetarëve ju do rrisni rrogat, sepse rritje ekonomike ju nuk keni se nuk ka shtim popullsie. Jua kam thënë shumë herë vij nga fusha e biznesit, nëse njerëzit emigrojnë nga një vënd, nuk ka zhvillim ekonomik. Do të thotë që ka regres në atë vënd. Sepse një qytetar nuk ka pse të lej vëndin e tij dhe të shkojë në vënd tjetër. Kaq kisha për performancën tënde të bashkisë dhe të qeverisë.

Bukurosh Stafa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Do që ta shikoj gotën bosh ndërsa pozita do ta shikoj plot sigurisht. Dhe ky debat veçanërisht bëhet kur miratohet buxheti. Unë po e shikoj gjysëm plot. Unë nuk jam

dakort fare me ato që u thanë këtu nga opozita, nuk është aq e zezë situata. Situata nuk është se është perfekte dhe është e mirë, nuk është atje ku duhet të ishte apo ku mund të ishte, por nuk është kaq e zezë për mendimin tim. Tarifat sigurisht që janë rritur por tarifat do rriten në mënyrë proporcionale, me rritjen e qytetit, me përmirsimin e jetesës sepse njerëzit konsumojnë më shumë dhe bëjnë plehra më shumë, ndotin më shumë etj etj. Me rritjen e mirqënies njerëzit kërkojnë një sjellje më qytetare, më të përsosur ndaj tyre, kështu që bashkisë I shtohen detyrimet ndaj qytetarëve dhe ato detyrime do ti shtohen qytetarëve. Nuk është e vërtetë që në fshatra nuk ka ndriçim, në të gjitha Njësitë Administrative ka ndriçim dhe ndriçimi është mirëmbajtur. Në raste të veçanta nuk ka patur se u dogj një llampë etj. Kudo që shkon nëpër takime ata të kërkojnë vendosje llampash. Ndriçimi është bërë dhe është bërë shumë mirë. Gjithsesi edhe këtu ajo bëhet me lekë, nuk bëhet gjë pa lekë, duhet të vijë këto lekë. Prandaj pavarësisht nga dobësitë, unë jam dakort me ato që u thanë këtu që ka vend për përmirsim veçanërisht në mënyrën e vjeljes së taksave. Për shembull një familje që ka më shumë duhet të paguajë më shumë, një familje që ndot më pak duhet të paguajë më pak. Këtë mund ta shikojë bashkia në të ardhmen. Unë jam tani që këto tarifa që janë vendosur tani janë të arsyeshme, të përballueshme dhe propozojmë që ta miratojmë këtë projekt. Ju faleminderit.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit Zoti Bukurosh. Ka një propozim nga Anëtar i Këshillit Z. Afrim dhe të kalojmë direkte në votim.

Afrim Qosja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Do kërkoja mirëkuptimin e të gjithëve për një propozim për ulje tarife e cila është për njësi dhe që dëmton ata që merren direkt me bujqësinë. Jam për uljen e tarifës për ujitjen e kanalit të hapur nga 330 lekë në 300 lekë sepse kjo do të rriste koston e prodhimit pasi vaditja do të bëhet shumë herë gjatë periudhës së sezonit dhe do të rriste kostot për njësi. Për këtë tarifë e cila ndryshe nga tarifat e tjera që paguajnë një herë në vit, kjo paguhet për njësi dhe sa herë është shpeshtësia e vaditjes. Faleminderit.

Erion Murataj-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Marr shkas nga propozimi i kolegut, meqë po i vini barrë në kurriz fshatit për pastrime, gjelbërime që janë pa sens për mua por ju do e miratoni se keni

votat.Përsa I përket vadtjes, jo vetëm ta lini në nivelin që ka qënë tarifën po dhe ajo tarifa që të vaditësh me pompën tēnde duke I paguar energjinë elektrike shtetit të rritet, mua më duket pa sens.Kështu që tek vaditja shtojini propozimit të zotërisë edhe propozimin tim që vaditja të rrijë në të njëjtat tarifa që ka qënë e në qofshi burra ti ulni akoma.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Murataj ajo është thjesht një zë që do tregohet, unë nuk di që vadit njeri aktualisht me pompë, është një zë që është futur edhe ishalla po tentoj që të vadisin.E hedhim në votim paketën fiskale.Biem në parim se nuk është shkruajtur atje, nuk del.Kush është pro propozimit që dha Z.Afrim dhe Z.Murataj?Të ulet çmimi tek vaditja me pompë në një kohë që ska fare..çfarë propozon ti?

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë propozoj rrëzimin e paketës

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Z.Afrim ishte konkretisht nga 3300 të bëhet 3000, Z.Murataj thotë mos rritet vaditja me pompë pra është një propozim tjetër në zërin që ka aty tek paketa fiskale se unë se kam parasysh sesa është.Sa është dhe sa u bë?

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Nga 100 është 200

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pra jeni dakort të hiqet dhe ky?Hapet votimi për paketën fiskale me 2 ndryshimet që propozuar shokët.

Enerieta Ferra – Zv.Kryetare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Po pse ta lem 3000 lek, ka një studim, ka një kosto, ai që e ka relatuar e ka sjellë këtu e kemi diskutuar

Asim Sula-Zv.Kryetar I Bashkisë Elbasan

Të nderuar Antarë të Këshillit Bashkiak, faktikisht është shumë e rëndësishme që diskutimet që bëhen në këtë sallë janë diskutime potenciale dhe profesionale.E

them këtë për të gjithë diskutimet që janë bërë deri tani. Doja të prekja pak propozimin që bëri Afrimi. Normalisht bëhet fjalë për të mos rritur tarifën e vaditjes.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Hapim votimin

Këshilli Bashkiak me 28 vota pro, 10 kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

(B.Çopja; L.Hasa; E.Jaurri; A.Kana; D.Madhi; A.Meçja; R.Mita; E.Murataj; E.Muzhaqi
Z.Muzhaqi)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetar i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 6 e rendit të ditës

6. Mbi miratimin e listës emërore të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje , për vitin 2026, në qytetin e Elbasanit.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Në komision ka kaluar dhe është diskutuar.Kishte ndonjë gjë të veçantë?Listat I keni pro

Shefqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Realisht kjo kaloi.Bashkia Elbasan ka aplikuar pranë Ministrisë Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit për përfitimin e fondit që do shërbejë për subvencionimin e qerave për vitin 2026 për familjet që futen në programin social të strehimit.Subvencionimi përfshin individët që dalin nga sistemi I përkujdesjes alternative që janë listuar këtu në relacion kush janë kategoritë që përfitojnë.Për këtë është bërë njoftim në media.Komisioni I strehimit ka hartuar proces verbalin përkatës dhe ka rezultuar që përfitojnë 292 familje me një fond prej 26.358.849 lekë që janë nga Ministria e Financave që mbulon 70% dhe 30% I mbulon bashkia.


Këshilli Bashkiak me 29 vota pro,3 kundër, 4 abstenim, miraton sa më sipër.

(E.Jaurri;E.Murataj;E.Muzhaqi)

(B.Çopja;A.Kana;A.Mecja;R.Mita)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Procesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetar I Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 7 e rendit të ditës

7. Detajim i shtesës së fondeve për SHMZSH.

Shefqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Në bazë të vendimit të fundit të qeverisë për shpërblimin e zjarrfiksave për ditët që ata janë përballuar me zjarrin duhet të jepet një shpërblim për ata që janë angazhuar për këto ditë. Qeveria ka akorduar Bashkisë Elbasan 2.883.000 lekë shtesë fondi të cilat do të përdoren për shpërblimin. Diferenca nëse mbetet do të përdoret për investime po tek zjarrfiksjat. Nga përllogaritjet e bëra një pjesë është mbuluar edhe nga pagat e vitit 2025. Rezulton që ka një teprice fondi, që është 215.800 lekë të cilën drejtoria përkatëse e propozon për zërin investime që janë blerje kit, sharrë elektrike me bateri dhe grepa zjarri dinamik me 4 pjesë. Pra është përdorur gjithë fondi, pjesa më e madhe është përdorur për shërbimin e zjarrfikseve, investime po brenda sektorit të zjarrfikseve.

Erjon Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Propozimi im në këtë rast është që shpërblimi për zjarrfiksit të detajohet, për ata që kanë luftuar zjarrin dhe për ata që kanë larë markatën. Se kur ra zjarri e kemi vet të faktuar nga faqja e bashkisë, një pjesë e zjarrfikseve po lanin markatën kështu që detajoeni këtë pagesën, shpërblimin. Përsa i përket grepave na duhen ca grepa të peshkojmë ca qyqarë atje në zjarrfikse që po vjedhin qytetarët e Elbasanit me nga 10.000 a 20.000 lekë duke shpërndarë certifikatat e MZSH-së.


Këshilli Bashkiak me 32 vota pro, 2 kundër, 3 abstenim, miraton sa më sipër.

(B.Çopja; D.Madhi)

(A.Meçja; E.Muzhaqi; Z.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetar I Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 8 e rendit të ditës

8. Për korrigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga dëmtimi i banesës, si pasojë e rrëshqitjes së tokës së Z. Pren Mihal Bërdufi banorë në Fshatin Stërstan, Njësia Administrative Gjinar, përcaktuar në VKB Nr.172 datë 04.12.2019 të Bashkisë Elbasan.

Shfaqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Këto janë dëme të shkaktuara para vitit 2019, është bërë dokumentacioni përkatës, Agjensia Kombetare e Mbrojtjes Civile kërkon një konfirmim për të shpërblyer por

gjatë procedurave të komisionit përkatës të ngritur më parë kanë bërë dhe gabime teknike se një pjesë janë referuar manualit të ndërtimit të vitit 2015 ku është përfshirë edhe tvsh-ja e cila tvsh-ja bie ndesh me vendimin nr 329 dhe është ngritur një komision tjetër që ka riparuar korrigjimet e nevojshme. Korrigjime që janë në bazë të kodit të procedurave administrative dhe mbështetur në çmimet e Entit Kombëtar të Banesave, dhe dalin diferenca shumë të vogla që nuk ngrenë peshë specifike 1-2% më shumë. Pra të 4 rastet janë korrigjime të nevojshme që duhen plotësuar që duhet tja çojmë Ministrisë përkatëse të bëj likujdimet e nevojshme këtyre familjarëve.

Altin Meçja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

3 familjarë nga këto i njoh Z.Muzhaqi, Z.Pisha dhe Z.Dervishi. Problemi është se 2 nga këta kanë vdekur, pse nuk u bënë në kohë? Pjesën më të madhe e sqaroi dhe Shefqeti, unë do doja që këto të gjitha të kalojnë, edhe ato 2 familjet e tjera e njëjta gjë. Dhe nuk e kam fare për politikë, është e vërtetë kjo që po them.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Hapet votimi.

Këshilli Bashkiak me 37 vota pro,- kundër,- abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetar I Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 9 e rendit të ditës

9. Për korrigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Myftar Ibrahim Dervishi banorë në Fshatin Xibrakë, Njësia Administrative Labinot Fushë, përcaktuar në VKB Nr.162 datë 27.11.2020 të Bashkisë Elbasan.

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro,- kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetar I Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 10 e rendit të ditës

10. Për korrigjimin e ndihmës financiare, dhe miratimin e vlerësimit të dëmeve nga ana ndërtimore dhe dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektro-shtëpiake, të shkaktuara nga zjarri në familjen e Z. Hysen Sali Pisha banorë në Fshatin Benë, Njësia Administrative Labinot Mal, përcaktuar në VKB Nr.30 datë 20.02.2018 të Bashkisë Elbasan.

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro,- kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Muzhaqi)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetar I Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan


Pika 11 e rendit të ditës

11. Për korrigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga dëmtimi i banesës, si pasojë e rrëshqitjes së tokës së Z. Hasan Xhevit Muzhaqi banorë në Fshatin Polis i Vogël, Njësia Administrative Shushicë, përcaktuar në Vendimin Nr.84 datë 12.06.2015 të Këshillit të Komunës Shushicë, Elbasan.

Këshilli Bashkiak me 34 vota pro,- kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetar I Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 12 e rendit të ditës

12. Për miratimin e kriterëve mjedisore dhe vizuale për licencimin e mjeteve taksi (4+1) në Bashkinë Elbasan.

Klodian Çekrezi-Përfaqësues i Administratës

Nga Janari i vitit 2026 liçensat për operatorët e rinj 4+1 mendojmë tja japim mjeteve green, mjeteve elektrike dhe hibride. Sa për liçensimin e mjeteve aktuale do të liçensohen mjetet që janë jo më të vjetra se 15 vjet nga viti i prodhimit. Pas Janarit 2030 nuk do të lejohet më liçensimi jo green.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kjo historia me taksistët nuk e di pse herë pas here do të duhet të krijojmë situata artificiale dhe kjo kam përshtypjen që edhe deklarimi I zotërsisë që 30% e taksive janë mbi 15 vjet prapë do krijojë një situatë. Unë mendoj që në rast se ne i privojmë të drejtën e liçensimit, subjekteve tregtare që kanë kaq vite operim, që mirë apo keq I kanë shërbyer qytetarëve të Elbasanit, minimalisht kjo duhet shoqëruar me atë siç thoshte kryeministri, garanci sovranë që këta të ndryshojnë mjete sepse nuk I dimë kushtet ekonomike si I kanë. Nuk I dimë si I kanë pasqyrat financiare, pra analiza për miratimin e kriterëve të reja ndërkohë që kemi 30% flotë të amortizuar dhe të vjetër mendoj unë ose shtyjeni, ose do ta plotësoni gjënë që bashkia ti gjendet në krahë atyre edhe për të ndryshuar mjetin, qoftë duke dalë garant për të marrë një mjet të ri se mbase si kanë mundësitë për të blerë një të ri. Ne vimë ktu thjesht të votojmë që mos jemi më në treg mos ti rinovojmë liçensën sikur... e qartë pra deri në 2030 por deri në 2030-tën ai nuk e dryshon makinën sot për nesër sepse edhe për të marrë një makinë me leasing ke një procedurë 3 mujore. Unë po të them se makinat e reja me hyrjen në fuqi të ligjeve të reja sidomos për këto elektriket

thuhet që në janar do rriten shumë vlerat e mjeteve elektrike se këtu po synohet të shkohet te mjetet elektrike. Duhet të ketë një support të themi garantor bashkia për një subject që ka kaq vite që operon? Gjykojeni, shyrtojeni këtë mundësi që bashkia të dali garant për rinovimin e këtyre flotave për rata që nuk kanë mundësi. Për ata pastaj që kanë pasqyra financiare me fitim të vazhdojë.

Asim Sula-Zv. Kryetar I Bashkisë Elbasan

Ndonjëherë diskutimet dalin edhe nga konteksti por ajo që duhet të kuptojmë te kjo masë kemi të bëjmë me përmirsim kriteresh që do të thotë impakti këtu është në mjedis. Ajo që duhet të punojmë dhe ti përafrohemi standartit të Europës dhe orientimeve që jep Europa është të ndotim sa më pak mjedisin tonë ku jetojmë. Dhe ky është impakti i këtij vendimi që ne po marrim sot. Pra varet nga këndvështrimi si ne i shohim sot e si i kuptojmë gjërat. Sigurisht mund të ketë impakt të dëmshëm ekonomik tek disa taksi që nuk mund të blejnë një mjet më të rip or për këtë është lënë një periudhë deri në 2030. Kanë 5 vjet të reflektojnë për ndryshimin pra çdo masë ka një ndikim më të madh për banorët dhe për komunitetin ku ne jetojmë. Është shumë e rëndësishme të shikohet në këndvështrimin pozitiv.

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kisha unë diçka për të shtuar te kjo pikë. Përsa i përket kësaj që kërkon bashkia përsa i përket green-it, jam dakort edhe me atë të liçensaveve e pyeta drejtoreshën që ishte aty dhe më tha që liçensa do të jepet vetëm për kompani, nuk do të jepet më për individë kështu që nëse qytetarët duan të informohen ta kenë këtë informacion. Nuk do të ketë më individë që do të operojnë por unë e kam shqetësimin tek ato që e kanë aktualisht dhe i bashkohem shqetësimit të Z. Murataj dhe propozova edhe tek komisioni që bashkia tek paketa fiskale që do të vijë, të shikoni një zë aty, këtë e propozoj që për taksixinjtë që janë aktualisht sepse unë ato i konsideroj kontributor prej kaq vitesh në atë profesion. Me ato makina që kanë patur, me ato mundësi që kanë patur, ja kanë ofruar qytetarëve një shërbim cilësor apo jo cilësor, e kanë vendosur vetë qytetarët nëse i kanë marrë apo si kanë marrë. Kjo është çështje tregu. Por ju të përcaktoni një... jo të gjithë ata mund të jenë të mundur të blejnë një makinë green apo të bashkohen apo të piquen. Një propozim tjetër që bashkia ato ti marri në një konsultim publik të vërtetë, jo nga ato që bëhen dhe ti propozohet që ato individualisht të fillojnë të mendojnë që të bashkohen dhe të bëhen kompani, mos mendojnë që do të bëhen individualisht sepse mund të jenë

edhe të pa informuar dhe gjenden para faktit që kur vjen momenti I skadimit të ligjit ai thotë pastaj ngela pa punë.Dhe na dalin në protestë siç na dolën para ca kohësh dhe na hapen probleme sociale kështu që shikojeni tek paketa që paratë I keni, mundësitë I keni.Mjafton vetëm një vullnet dhe një bashkëpunim me ta.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Do ti kemi parasysh sygjerimet e juaja.Sot projekt-vendimin tuaj jemi të detyruar ta hedhim në votim.Hapet votimi.


Këshilli Bashkiak me 28 vota pro,2 kundër, 4 abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Marku;E.Murataj)

(B.Çopja;D.Madhi;A.Meçja;E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetar I Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 13 e rendit të ditës

13. Relacion për transferimin e aseteve nga Agjencia e Mbikqyrjes dhe Kontrollit tek Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale dhe Bashkia Elbasan.

Shefqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Ky është një ndryshim, e miratuam dhe muajin e parë por gabimisht është lënë në harresë sepse disa punonjës së Agjensisë së Mbikqyrjes dhe Kontrollit e kanë kaluar tek Agjencia e Shërbimeve Rurale dhe në bashki. Por bashkë me personin që ka kaluar ata kanë kaluar dhe inventarin e zyrave dhe inventari I zyrave ishte harruar të kalonte muajin e parë dhe e ka sjellë tani drejtoria përkatëse pra bëhet kalimi I aseteve të zyrave përkatëse që kanë këta punonjës, që kanë kaluar nga Agjencia në Agjensinë tjetër Rurale dhe në Bashkinë e Elbasanit disa punonjës.

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, 2 kundër, 4 abstenim, miraton sa më sipër.

(D. Madhi; E. Murataj)

(B. Çopja; A. Kana; A. Marku; R. Mita)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetar I Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 14 e rendit të ditës

14. Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ka qenë 1 vit por ka një propozim që të bëhet 3 vjet.

Andi Liçi-Përfaqësues i Administratës

Në vijim të bashkëpunimit ose të marrëveshjes që Bashkia e Elbasanit ka me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës për ndihmën që i jep bashkia jonë në matjet dhe në plotësimin e dosjeve të qytetarëve për të bërë sa më shpejt legalizimet. Ne e menduam të udhës që ta bëjmë marrëveshjen deri në vitin 2028 në mënyrë që mos ta përsërisim vit për vit sepse atëhere përfundon edhe afati ligjor i përfundimit të legalizimeve. Marrëveshja e parë që u mbyll, pasi unë një muaj e pak kam drejtor në drejtorinë e legalizimeve, të jap ca statistika të vogla. Bashkia e Elbasanit ka realizuar 303 matje dhe këto janë kthyer në vendime e legalizime janë kthyer 62 matje. Në proces matje janë edhe 32 të tjera dhe pjesa e mbetur është në proces pune në ASHK-në. Këto janë statistika e vitit të parë të Bashkisë Elbasan. Nëse keni ndonjë pyetje.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

E vetmja gjë që unë kisha tek pjesa e bashkëpunimit. Bashkia luan thjesht rolin e matësit këtu? Apo ndihmon në proces ose ato që janë harruar si dosje?

Andi Liçi-Përfaqësues i Administratës

Bashkia e Elbasanit në bashkëpunim me ASHK-në vendosin për zonat prioritare dhe ne jemi drejtori ndihmëse sigurisht sepse vendimin e legalizimit në fund e merr ASHK. Ne jemi ndihmës në terren për procesin e matjeve dhe duke përgatitur planimetritë e shtëpive.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Llogjikisht kur thua se jemi ndihmëse do të thotë që lokomotiva është ASHK-ja teorikisht, që do të thotë kur lokomotiva është institucion tjetër i bie që ta kërkojnë ata marrëveshjen. Marrëveshjen e keni kërkuar ju apo ata?

Andi Liçi-Përfaqësues i Administratës

Përsa i përket marrëveshjes, unë nuk kam qenë në atë kohë që është bërë marrëveshja sepse është bërë një vit përpara por nuk është lokomotiva ajo. Duket si lokomotiva pasi firmën e fundit e ka ASHK-ja. Po kjo është një marrëveshje dhe e vendosim të dyja bashkë cila është zona prioritare apo cilës zonë do ti japim prioritet që ka më shumë probleme apo më shumë legalizime të pabëra. Faleminderit.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Dihet që duhet po-ja e të dyjave por puna është kush bën rregullat.


Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 2 kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(D.Madhi; E.Murataj)

(E.Jaurri; R.Mita)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025, ora 13:10 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Zv. Kryetar I Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 15 e rendit të ditës

15. Për miratimin e planit të aktiviteteve, konsultimeve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak Elbasan, viti 2026.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kjo është një praktikë që bëhet çdo vit dhe kërkon të miratohet. Hapet votimi. Të them dhe dy gjër. Një njoftim e kemi për nesër për festat e nëntorit për nesër në orën 10:00 dhe në datë 29 tek varrezat e dëshmorëve. Jeni të mirëpritur të gjithë. Njoftimi I dytë është që të ikim në Prizren për të bërë një vizitë pune dhe na duhet konfirmimi juaj. Do bëjmë një program për tu konsultuar dhe nëse ndonjëri prej jush ka ndonjë sugjerim, pse jo. Do të jetë vetëm një nate. Një nga këto do ishte shkëmbimi I eksperiencës së buxhetimit me pjesëmarrje. Punë të mbarë!

Këshilli Bashkiak me 28 vota pro,- kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbledhja përfundon në orën 15:00

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

